



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE (Pasqyra 14 Sh)

DHJETOR, 2025

Buletini Mujoy i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe bazohet në të dhënat e raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin dhjetor 2025 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), të cilat krahasohen nga Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP. Ky raport paraqet kryesisht rastet e konfirmuara dhe në disa raste edhe rastet e dyshuara dhe të konfirmuara.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit dhjetor 2025 zënë 26 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 248.2/100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 9.7/100.000 banorë. NJVKSH Berat dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastro-enterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa bashkive për diagnozën e saktë klinike dhe konfirmimin e saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin dhjetor 2025 në nivel kombëtar.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin dhjetor 2025
(Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste dhjetor 2025	Incidenca dhjetor 2025 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0.00
Salmoneloza	8	0.33
Shigelozë (Disenteri bacilare)	9	0.37
Dizenteri amebike	0	0.00
Toksiko-infeksione alimentare	233	9.70
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	5713	237.83
Sëmundje diarreike në total	5963	248.24

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit dhjetor 2025 janë raportuar në total 216 raste variçelë (incidenca 8.99/ 100.000 banorë) nga të cilat, 211 raste janë të dyshuara dhe 5 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen variçelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 97 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 78 raste, grafiku 1.

Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës




2.2 Fruthi

Gjate muajit Dhjetor jane raportuar 3 raste tekonfirmuar me fruth.

Muaj	Nr rastesh	Incidenca
Janar	1	0.04
Shkurt	3	0.12
Mars	10	0.42
Prill	0	0
Maj	1	0.04
Qershor	0	0
Korrik	0	0
Gusht	1	0.04
Shtator	0	0
Tetor	1	0.04
Nentor	0	0
Dhjetor	3	0.12

Grafiku 2. Shperndarja e rasteve te konfirmuar sipas dates te fillimit te rashit



Rastet gjate ketij muaji i perkasin bashkise Tirane, te grupmoshes 0-4 vjec, te pavaksinuar, te shtruar ne spitalin pediatrik QSUT.

Hetimi epidemiologjik i rasteve eshte kryer nga sherbimi i epidemiologjise Tirane, ku jane identifikuar kontaktet dhe jane marre masat e kontrollit te infeksionit.


Hepatitet virale

3. Hepatiti Viral B (HBV)

Ne muajin dhjetor jane raportuar 66 raste te dyshuar nga te cilat jane konfirmuar 55 (83.3%) raste me HBV. Incidenca e HBV ne muajin nentor eshte 2.3 raste/100 000 banore ne vend. Prej tyre 30 jane te gjinise mashkull (54.5%) dhe 25 femra (45.5%).


Muaj	Incidenca	Nr rastesh
Janar	0.8	20
Shkurt	1.4	34
Mars	1.2	29
Prill	1.3	32
Maj	1.4	34
Qershor	1.6	38
Korrik	1.2	29
Gusht	0.7	17
Shtator	0.5	14
Tetor	0.8	21
Nentor	0.9	22
Dhjetor	2.3	55

Graf.3 Shperndarje e rasteve me HBV sipas bashkive dhe muajve



Ne muajin dhjetor rastet jane te shperndara ne disa bashki (Graf 1) ku numrin me te larte e ka Tirana me 25 raste dhe Fieri me 11 raste te konfirmuar.

Graf .4 Shperndarje e rasteve me HBV sipas grupmoshave (vite)




Rastet ne muajin dhjetor i perkasin grupmoshes adulte mbi 30 vjec (graf 2) dhe mungese e tyre ne grupmoshat pediatrike, kjo ne saje te vaksinimit ndaj HBV ne keto grupmosha.

Hepatiti viral C (HCV)

Ne muajin dhjetor jane raportuar 14 raste te dyshuar nga te cilet jane konfirmuar 3 (21.4%) raste me HCV. Incidenca e HCV per keto muaj eshte 0.12 raste /100000 banore. Te tre rastet I perkasin gjinise mashkullore.


Muaj	Raste	Incidenca
Janar	3	0.12
Shkurt	5	0.21
Mars	6	0.25
Prill	6	0.25
Maj	5	0.21
Qershor	6	0.25
Korrik	9	0.4
Gusht	3	0.1
Shtator	5	0.2
Tetor	6	0.24
Nentor	7	0.29
Dhjetor	3	0.12

Graf.5 Shperndarje e rasteve me HCV sipas bashkive dhe muajve



Rastet i perkasin bashkise Lushnje (1 rast) dhe Tirane 2 raste. (graf 5).

Graf. 6 Shpërndarje e rasteve me HCV sipas grupmoshave (vite)




Gjate muajit dhjetor, rastet jane te grupmoshave adulte mbi 40 vjec (graf.6)

4. Sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS

Gjatë muajit Dhjetor 2025 janë kryer **23 ekzaminime** për HIV (12 meshkuj dhe 11 femra) prej të cilëve 2 raste (2 meshkuj) kanë rezultuar HIV pozitiv (Grafiku 7).

Grafiku 7. Shpërndarja e testimeve për HIV dhe rasteve të konfirmuara sipas gjinisë në muajin Dhjetor 2025.



Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitive është : **2 raste** Tiranë.

Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: **2 raste** i përkasin grup-moshës 25-34 vjeç.

Rastet e konfirmuara kanë ardhur nga laboratorë/spitale private (**2 raste** Genius).

Sifiliz dhjetor 2025

Gjatë muajit dhjetor 2025 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 3 raste të konfirmuara me Sifiliz.

Rastet e raportuara, të konfirmuara, janë 2 meshkuj e 1 femrë. Shpërndarja sipas grupmoshave është nga 2 raste për grupmoshë, 25-34 vjeç dhe në grupmoshën 35-44 vjeç është një rast.

Rastet vijnë nga bashkitë: Berat, Korçë dhe Tiranë.

5. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit Dhjetor 2025 janë raportuar gjithësej 20 raste me tuberkuloz (TB), nga të cilat 16 raste janë pulmonarë dhe 4 rast janë ekstrapulmonarë.

Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara pozitivë.

Rastet pulmonare përkatësisht janë: 5 në Tiranë, 1 në Kukës, 1 në Dibër, 2 në Berat, 1 në Librazhd, 1 në Lushnjë, 1 në Mirditë, 1 në Shijak, 1 në Vlorë dhe 2 në Shkodër. (total 16)

Rastet ekstrapulmonare janë përkatësisht: 1 në Tiranë, 1 në Shkodër, 1 në Elbasan, dhe 1 në Pogradec. (total 4)

Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh.

6. Sëmundjet zoonotike

Tabela 4. Shpërndarja e zoonozave në muajin dhjetor 2025, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikeciozë)

	Dhjetor (raste 2025)	Incidenca (raste/100,000) 2025
Antraks (Plasje)	0	0.00
Brucelozë	5	0.21
Leptospirozë	0	0.00


Për muajin dhjetor janë raportuar 5 rast Brucelozë perkatesisht : 2 nga Dibra, 1 Gjirokaster, 1 Elbasan , 1 Kukes.

7. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

7.1 COVID-19 dhjetor 2025

Gjatë muajit dhjetor 2025 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 37 raste të konfirmuara me COVID-19 dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin dhjetor është 1.54 raste /100000 banorë.


Grafiku 8. Shpërndarja e rasteve sipas grupmoshave (dhjetor 2025)



Grupmosha më e prekur për këtë muaj është grupmosha 45-54 vjec me 7 raste e ndjekur nga ato 35-44 vjec dhe 55-64 vjec me nga 5 raste.

Gjatë këtij muaji janë shtruar në spital 3 raste të konfirmuara me COVID-19, të gjitha të grupmoshës 65-74 vjec.

Grafiku 9. Shpërndarja e rasteve sipas bashkive (Dhjetor 2025)




Numrin më të madh të rasteve e kanë bashkitë Skrapar, Devoll, Tiranë, Vlorë, etj.

Gjatë muajit dhjetor 2025 është raportuar zero raste vdekje. Konfirmimi i rasteve është bërë në 92% (34 raste) janë konfirmuar në laboratorët e NJVKSH-ve dhe 8% (3 raste) janë konfirmuar në laboratorin e ISHP.

7.2 Grip

Gjatë muajit dhjetor janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 405 raste të dyshuara me Grip , nga të cilat 43 raste kanë rezultuar pozitive dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin dhjetor është 1.79 raste /100000 banorë.

Grafiku 10 tregon shpërndarjen e rasteve sipas tipit të viruseve qarkullues. Vërehet mbizotërim i gripit Tipi A, perkatesisht nentipi AH3.



Në muajin dhjetor qarkullimi i gripit arriti intensitet mesatar duke paraqitur aktivitet sezonal normal të zakonshëm dhe të pritshëm për stinën, dhe përhapje gjeografike rajonale. Raste me grip u identifikuan si nga survejanca sentinel ILI-SARI, ashtu edhe nga survejanca virologjike josentinel.

INSTITUTI I
SHËNDETIT
PUBLIK

DEKSI

